

Banka e Shqipërisë

LLOGARITË FINANCIARE TË SHQIPËRISË 2022

Departamenti i Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë.

TETOR 2023

PËRMBAJTJA

1.	<i>Hyrje</i>	4
2.	<i>Mjetet dhe detyrimet financiare të sektorëve institucionalë</i>	6
3.	<i>Ndërlidhja financiare e sektorëve institucionalë</i>	8
4.	<i>Zhvillimet sipas sektorëve institucionalë</i>	10
4.1	<i>Ekonomitë familjare</i>	10
4.2	<i>Korporatat jofinanciare</i>	12
4.3	<i>Qeveria e përgjithshme</i>	14
4.4	<i>Korporatat financiare</i>	16
	<i>Korporata depozituese përveç bankës qendrore</i>	19
	<i>Fondet e investimeve</i>	20
	<i>Kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit</i>	20

HYRJE

Llogaritë Financiare Kombëtare (në vijim "llogaritë financiare") janë një nga komponentët e llogarive kombëtare dhe mund të përshkruhen si një grup i strukturuar dhe koherent informacioni statistikor, i cili regjistron transaksionet financiare - flukse dhe stoke - midis sektorëve të ndryshëm institucionalë të ekonomisë, si dhe ndërmjet këtyre sektorëve dhe pjesës tjetër të botës, të ndara sipas llojeve të ndryshme të instrumenteve financiare.

Llogaritë financiare ofrojnë informacion të plotë mbi operacionet dhe strukturën e ndërmjetësimit financiar në vend, si dhe tregojnë kanalet kryesore të përdorura për të përftuar dhe investuar zotërimet financiare. Kjo statistikë është një burim i rëndësishëm informacioni për analiza të politikës monetare dhe stabilitetit financiar.

Hartimi i llogarive financiare në Bankën e Shqipërisë bazohet në udhëzimet e përcaktuara në metodologjinë e sistemit evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale (ESA 2010). Manuali ESA 2010 (Sistemi Evropian i Llogarive) është një standard ndërkombëtar që shërben për hartimin e statistikave të llogarive financiare, për të gjitha vendet në Evropë¹.

Llogaritë financiare hartohen të detajuara për të gjithë sektorët e ekonomisë: sektorin e korporatave jofinanciare (S.11), sektorin e korporatave financiare (S.12), sektorin e qeverisë së përgjithshme (S.13), sektorin e ekonomive familjare dhe institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë individëve (NPISSH) (S.14+S.15) dhe sektorin e jorezidentëve (S.2). Ajo paraqitet e plotë për vitet 2013-2022.

Banka e Shqipërisë publikon statistikën e Llogarive Financiare vjetore të Shqipërisë në faqen zyrtare të internetit, në seksionin Statistikat/Llogaritë Financiare/Aneks Statistikor. Shënime metodologjike për hartimin e llogarive financiare gjenden gjithashtu të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë. Të dhënat e detajuara për secilin sektor dhe nënsektor të ekonomisë janë publikuar në format excel në Aneksin Statistikor².

Seksioni i dytë i materialit prezanton situatën e Llogarive Financiare në vitin 2022, si dhe ecurinë e tyre ndër vite. Seksioni i tretë ndalet në lidhjen ndërmjet sektorëve institucionalë dhe seksioni i katërt paraqet situatën e mjeteve financiare dhe të detyrimeve për çdo sektor të ekonomisë së vendit, pjesë e bllokut të llogarive financiare.

¹ Më gjerësisht, metodologjia shpjegohet në botimin e Bankës së Shqipërisë "Llogaritë financiare sektoriale: Shënime metodologjike".

² Llogaritë financiare (Aneks Statistikor)

KOMENTE TË PËRGJITHSHME PËR LLOGARITË FINANCIARE TË SHQIPËRISË

Sistemi i llogarive kombëtare i klasifikon njësitë institucionale³ në bazë të aktivitetit kryesor ekonomik dhe sipas rolit që luajnë në ekonominë e vendit. Sektorë institucionale janë: korporatat jofinanciare, korporatat financiare, qeveria e përgjithshme, ekonomitë familjare dhe institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të familjeve.

Korporatat jofinanciare dhe korporatat financiare përfshijnë njëkohësisht korporatat private dhe ato publike (me aksione të zotëruara nga qeveria). Banka e Shqipërisë publikon çdo vit listën e përditësuar të institucioneve financiare.⁴

Qeveria e përgjithshme përfshin ato njësi institucionale, të cilat janë prodhues jotregu ose të cilat kanë funksion kryesor rishpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë kombëtare dhe ku më shumë se 50% e aktivitetit të tyre financohet nga buxheti i qeverisë. Sektori i qeverisë së përgjithshme përbëhet nga tre nënsektorë: qeveria qendrore, qeveria lokale dhe fondet e sigurimeve shoqërore. INSTAT publikon çdo vit listën e përditësuar të institucioneve të sektorit publik⁵.

Sektori i ekonomive familjare përbëhet nga individë dhe grupe individësh, të cilët janë kryesisht konsumatorë. Në sektorin e institucioneve jo me qëllim fitimi në shërbim të familjeve (NPISH) përfshihen njësi ligjore të pavarura, të cilat u shërbejnë ekonomive familjare dhe nuk prodhojnë për tregun. Institucione të tilla i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse.

Mjetet financiare dhe detyrimet klasifikohen në instrumentet financiare: monedha dhe depozita, letra me vlerë të borxhit, hua, kapital dhe aksione në fonde investimi, sigurime dhe skema pensioni, derivativë financiarë dhe llogari të tjera të arkëtueshme/të pagueshme. Dy instrumente të tjera, ari monetar dhe mbajtjet e SDR, shfaqen vetëm në sektorin e korporatave financiare në nënsektorin e bankës qendrore.

³ Një njësi institucionale karakterizohet nga autonomia e vendimmarrjes në çështjet ekonomike, ku ose ruan një strukturë të plotë të llogarive ose është në gjendje të përpilojë një të tillë. Duhet të theksohet se koncepti themelor i ndarjes së ekonomisë në sektorë institucionale sipas ESA 2010 ndryshon nga ai i klasifikimit të njërive ekonomike prodhuese sipas NACE (Klasifikimi i Veprimtarive Ekonomike).

⁴ Lista e institucioneve financiare, 2022, Banka e Shqipërisë

⁵ Lista e Institucioneve Publike, 2022, INSTAT

2. MJETET DHE DETYRIMET FINANCIARE TË SEKTORËVE INSTITUCIONALË

Grafiku 1 dhe tabela 1 prezantojnë llogaritë financiare të Shqipërisë në vitin 2022, të paraqitura në mjete financiare dhe detyrime të sektorëve institucionalë, të detajuara në instrumente financiare.

Mjetet dhe detyrimet financiare të sektorit të korporatave financiare paraqiten në volume të konsiderueshme. Kjo për shkak se institucionet e përfshira në këtë sektor veprojnë si ndërmjetës financiarë. Pozicionet me jashtë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të korporatave financiare.

Për sektorin e korporatave financiare, niveli i mjeteve financiare dhe detyrimeve është pothuajse i balancuar. Ndryshe paraqitet situata e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare. Për ekonomitë familjare, mjetet financiare në thelb tejkalojnë detyrimet, kryesisht për shkak të nivelit të lartë të investimeve në formën e depozitave, si dhe investimeve në formën e pjesëmarrjeve në kapitalin e korporatave jofinanciare.

Për korporatat jofinanciare, detyrimet tejkalojnë pasuritë financiare në mënyrë të konsiderueshme. Kjo për faktin se: së pari, krahas kredive dhe letrave me vlerë të borxhit, detyrimet përfshijnë gjithashtu vlerën e tregut të aksioneve të emetuara nga korporatat; dhe së dyti, mjetet jofinanciare të cilat përbëjnë pjesën kryesore të zotërimeve të këtyre lloj bizneseve nuk regjistrohen në llogaritë financiare. Më tej, paraqitja e të dhënave në llogaritë financiare bëhet në baza të pakonsoliduara, d.m.th. mjetet financiare dhe detyrimet brenda një sektori nuk netohen përkundrejt njëri-tjetrit, dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e korporatave jofinanciare.

Krahasimisht me volumin monetar të sektorëve të tjerë, mjetet financiare dhe detyrimet e sektorit të qeverisë së përgjithshme janë të ulëta (përkatësisht 6.4% dhe 17.7% të totalit të ekonomisë së brendshme).


Totali i mjeteve financiare të sektorëve të brendshëm të ekonomisë (sektorëve rezidentë), në vitin 2022, vlerësohet në 7,623.6 miliardë lekë, në rritje vjetore me 5.1%. Totali i detyrimeve u zgjerua me 4% në terma vjetorë, në nivelin 8,515.9 miliardë lekë. Në dimensionin e ekspozimit neto⁶, ekonomia shqiptare, në fund të vitit 2022, pozicionohet në huamarrës neto me rreth -892⁷ miliardë lekë. Ky nivel është rreth 4.7% më i ulët krahasuar me pozicionin prej -936 miliardë lekë në vitin 2021.

Seksioni 4 në vijim ofron një tablo më të detajuar mbi zhvillimet në mjete dhe detyrime financiare të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

⁶ Diferenca mes mjeteve dhe detyrimeve financiare.

⁷ Në përputhje me metodologjinë, ka një diferencë midis pozicionit financiar neto të ekonomisë së vendit dhe pozicionit financiar neto të sektorit jorezident, meqenëse ari monetar nuk ka kundërparti dhe regjistrohet vetëm si mjet i bankës qendrore.

Grafik 1. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të sektorëve institucionalë, 2022



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të sektorëve institucionalë, 2022
Në miliardë lekë

	Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Qeveria e përgjithshme	Ekonomitë familjare
Mjete financiare				
Ari monetar dhe SDR	0	47	0	0
Monedha dhe depozita	391	535	92	1,318
Letra me vlerë të borxhit	26	1,222	0	102
Hua	110	867	64	3
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	127	49	182	1,077
Rezervat teknike	21	6	0	8
Derivatet financiare	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	1,070	27	146	134
Totali	1,744	2,753	484	2,642
Detyrime				
Ari monetar dhe SDR	0	26	0	0
Monedha dhe depozita	0	2,264	0	0
Letra me vlerë të borxhit	26	9	811	0
Hua	792	114	429	301
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	1,995	281	0	0
Rezervat teknike	0	31	0	0
Derivatet financiare	0	0	0	0
Llogari të tjera të pagueshme	1,080	35	264	60
Totali	3,892	2,759	1,504	361

1 Zero absolute, zero e rumbullakosur ose vlerë e papërfillshme

- Jo e aplikueshme


.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3. NDËRLIDHJA FINANCIARE E SEKTORËVE INSTITUCIONALE

Tradicionalisht, llogaritë financiare bazohen në një përfaqësim dydimensional, i përqendruar në sektorin institucional dhe në instrumentin financiar, d.m.th. i secilit sektor institucional nga perspektiva e mjeteve dhe detyrimeve të tij financiare në instrumente të ndryshme financiare, pa identifikimin e palëve për të cilat këto mjete financiare/ detyrime mbahen/ kontrahohen. Për shembull, në paraqitjen dydimensionale të llogarive financiare, paraqiten vetëm pasuritë totale të ekonomisë familjare dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të individëve në formën e investimeve në letra me vlerë, pa identifikuar se cilët janë sektorët që emetojnë ato letra me vlerë. Në këtë mënyrë, ky informacion nuk lejon një specifikim të hollësishëm të marrëdhënieve që krijohen midis sektorëve të ndryshëm nga këndvështrimi kreditor/ debitor.

Ky seksion synon të analizojë modelet e financimit të vendosura midis sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, si dhe mes tyre dhe “pjesës tjetër të botës” (sektorit jorezident). Për këtë qëllim, informacioni mbi gjendjen financiare kombinohet me konceptin e rrjedhës së fondeve “nga kush-tek kush”⁸, në mënyrë të tillë që të mundësojë matjen e marrëdhënieve financiare ndërsektoriale në ekonominë shqiptare dhe shkallën e ndërveprimit të saj me botën (sektori jorezident). Grafiku 2 paraqet ndërlidhjen financiare të sektorëve institucionalë. Ndërtimi dhe interpretimi i tij paraqitet në shënimin në vijim.



⁸ Për më shumë informacion, konsultohuni me shpjegimin në botimin e Bankës së Shqipërisë “Statistikat e llogarive financiare për vitin 2017” dhjetor 2018, në seksionin metodologjik 1.5 Matrica “nga kush - tek kush” dhe rrjedha e fondeve.

Në dimensionin e ekspozimit neto, ekonomitë familjare dhe sektori jorezident pozicionohen në kreditorë ose huadhënës neto, ndërkohë që korporatat jofinanciare dhe qeveria e përgjithshme vijojnë në pozicion debitor ose huamarrës neto⁹. Për shkak të natyrës së biznesit, korporatat financiare shfaqin një pozicion neto shumë të ulët, afër zeros.

Sektori financiar, sektori korporata jofinanciare dhe ai jorezident evidentohen si sektorët kryesorë për sa i përket ekspozimit bruto¹⁰ (vektorët më të theksuar).

Gjithashtu, shkalla e integritit me jashtë (segmenti lidhës me sektorin jorezident) paraqitet e lartë për korporatat financiare, me një total të ekspozimit bruto prej 1,380 miliardë lekësh, rrjedhojë e investimeve në letra me vlerë, marrëdhënieve ndërbankare, depozitave të emigrantëve, si dhe pjesëmarrjes së huaj të kapitalit në sektorin bankar. I ilustruar me të dhënat në paraqitjen e llogarive financiare sipas matricës “nga kush – tek kush”, ekspozimi bruto i sektorit të korporatave financiare me jashtë (jorezidentët) përllogaritet si shumator i mjeteve (988) dhe detyrimeve (392) të korporatave financiare me jorezidentët (Tabela 2).

Tabelë 2. Paraqitja e llogarive financiare në matricën “nga kush - tek kush” - viti 2022, në miliardë lekë
Në miliardë lekë

		Sektori kreditor				
		Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Qeveria e përgjithshme	Ekonomitë familjare	Jorezidentët
Sektori debitor	Korporatat jofinanciare	856	464	379	1,054	1,139
	Korporatat financiare	448	390	105	1,423	392
	Qeveria e përgjithshme	263	605	n/a	100	536
	Ekonomitë familjare	54	306	-	n/a	0
	Jorezidentët	122	988	-	64	n/a

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për korporatat jofinanciare, totali i ekspozimit bruto me jashtë vlerësohet 1,261 miliardë lekë, dhe vjen kryesisht si pasojë e pjesëmarrjes në kapital në formën e investimeve të huaja direkte.

Qeveria e përgjithshme ka një vlerë të ekspozimit bruto me jashtë prej 536 miliardë lekësh, rrjedhojë e nivelit të lartë të financimit të huaj në borxhin e qeverisë.

Financimi brenda sektorit – si në vlerë absolute, ashtu edhe në përqindje ndaj ekspozimit total bruto – vërehet më i lartë në sektorin e korporatave jofinanciare (në nivelin 856 miliardë lekë).

⁹ Më gjerësisht, analiza e zhvillimeve të llogarive financiare për çdo sektor në seksionin 4.

¹⁰ Totali i mjeteve dhe detyrimeve financiare me sektorë të tjerë.


4. ZHVILLIMET SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALË

4.1 EKONOMITË FAMILJARE¹¹

Ekonomitë familjare zotërojnë rreth 35% të totalit të mjeteve financiare të brendshme. Në harkun kohor të një viti, mjetet e këtij sektori u zgjeruan me rreth 190 miliardë lekë dhe në fund të 2022 shënojnë 2,642 miliardë lekë.

Mjetet financiare të ekonomive familjare tejkalojnë ndjeshëm detyrimet e këtij sektori. Instrumenti kryesor i përdorur nga ekonomitë familjare vijon të jetë “monedha dhe depozitat”, i cili përfaqëson 49,9% të mjeteve financiare të këtij sektori, në fund të 2022. Ndërkohë “kapitali dhe aksione në fonde investimi” përbën 40,8% të totalit të mjeteve financiare.

Zgjerimi vjetor në mjete financiare të këtij sektori i atribuohet në masën më të madhe rritjes së investimeve në “kapital dhe aksione në fonde investimi” prej 98 miliardë lekësh, ndjekur nga zgjerimi i “monedha dhe depozitat” prej 55.1 miliardë lekësh.



¹¹ Përfshirë institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve (NPISH), të tilla si organizatat e ndihmës sociale, kishat, sindikatat, parti të politike dhe klubet argëtuese, të cilat u ofrojnë familjeve shërbime jotregu. Mjetet dhe detyrimet financiare të NPISH vlerësohen në më pak se 1% të totalit të aktiveve financiare dhe detyrimeve të ekonomisë familjare. Kur interpretohen të dhënat për mjetet financiare të këtij sektori duhet të konsiderojmë se të dhënat ekonomike janë në nivel të agreguar. Llogaritë financiare nuk disponojnë informacion në lidhje me mjetet financiare individuale të familjeve apo shpërndarjen e pasurisë brenda sektorit.

Tabelë 3. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të ekonomive familjare
Në miliardë lekë

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Mjete financiare									
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	938	955	984	996	1,022	1,085	1,183	1,263	1,318
Letra me vlerë të borxhit	76	83	80	92	96	86	81	81	102
Hua	5	2	2	3	3	3	3	2	3
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	569	668	614	568	681	716	745	979	1077
Sigurime dhe skemat e pensione	2	2	3	3	4	5	6	7	8
Derivativë financiarë
Llogari të tjera të arkëtueshme	176	80	99	101	98	125	112	119	134
Totali	1,767	1,792	1,781	1,764	1,904	2,019	2,129	2,452	2,642
Detyrime									
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të borxhit	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua	167	176	183	195	207	224	239	269	301
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Sigurime dhe skemat e pensione	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Derivativë financiarë
Llogari të tjera të pagueshme	23	24	11	11	12	12	12	53	60
Totali	190	200	194	206	218	236	250	321	361

Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlerë e papërfillshme


- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Detyrimet e ekonomive familjare përbëhen kryesisht nga kreditë hipotekare, të cilat zënë peshën më të madhe të totalit (rreth 46%), ndjekur nga kreditë konsumatore dhe huatë e tjera.

Detyrimi në "hua" i ekonomive familjare, në fund të vitit 2022, u zgjerua me 32.3 miliardë lekë dhe shënon vlerën e 300.9 miliardë lekëve. Transaksioni (fluksi) në "hua", pastruar për efekt të kursit të këmbimit dhe ndryshime të tjera, gjatë vitit 2022 shënon një zgjerim prej +36.3 miliardë lekësh. Detyrimi në "hua" ndaj sektorit të korporatave depozituese, përveç bankës qendrore (bankave të nivelit të dytë), u rrit me 27.5 miliardë lekë, në nivelin e 260 miliardë lekë, ndërsa "huatë" me institucionet e tjera financiare u zgjeruan me 4.7 miliardë lekë, në nivelin e 39 miliardë lekë.




4.2 KORPORATAT JOFINANCIARE

Detyrimet e korporatave jofinanciare (ose ndryshe bizneset) janë dukshëm në nivel shumë më të lartë se mjetet e tyre. Kjo, për arsye se mjetet jofinanciare nuk raportohen në llogaritë financiare. Për më tepër, krahas huave dhe letrave me vlerë të borxhit, detyrimet përfshijnë edhe aksionet e emetuara nga korporatat.


Në fund të vitit 2022, biznesi ose korporatat jofinanciare zotërojnë rreth 1,744 miliardë lekë mjete financiare, shifër e cila përbën rreth 23% të totalit të mjeteve të brendshme financiare. Mjetet financiare të korporatave jofinanciare janë në masën 22% në "monedha dhe depozita", ndjekur nga "aksione dhe kapital tjetër" 7% dhe "hua" 6%. Zotërimet në "sigurime dhe skema pensioni" dhe "letrave me vlerë të borxhit" së bashku përbëjnë vetëm 3% të aktiveve financiare. Instrumenti "llogari të tjera të arkëtueshme" është vlerësuar në rreth 61.3% të totalit të aktiveve financiare të korporatave jofinanciare. Ky zë, krahas kredive tregtare, regjistron edhe pretendime të tjera përkundrejt sektorëve të lidhur.

Investimet e sektorit në "monedha dhe depozita" u rritën me 33 miliardë lekë në nivelin 391 miliardë lekë në fund të vitit 2022. Mjetet financiare në formën e "huasë" u rritën me 8.5 miliardë lekë, në nivelin 110 miliardë lekë: huadhënia brenda sektorit u zgjerua me 9.2 miliardë lekë, ndërkohë që huadhënia ndaj sektorit jorezident u ul me 0.63 miliardë lekë. Investimet në "aksione dhe kapital tjetër" u rritën me 10.6 miliardë lekë në nivelin 127 miliardë lekë. Investimet në "letra me vlerë të borxhit" u rritën në drejtim të zgjerimit të investimit në tituj të Qeverisë Shqiptare.


Grafik 10. Mjete financiare të korporatave jofinanciare




Grafik 11. Detyrime të korporatave jofinanciare



Grafik 12. Përbërja e mjeteve financiare të korporatave jofinanciare, 2022



Grafik 13. Përbërja detyrimeve të korporatave jofinanciare, 2022



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të korporatave jofinanciare Në miliardë lekë

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Mjete financiare									
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	177	186	247	275	254	258	285	358	358
Letra me vlerë të borxhit	57	62	61	47	26	28	28	23	23
Hua	73	66	65	57	69	75	101	101	101
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	58	40	63	68	78	104	97	116	116
Sigurime dhe skemat e pensione	9	10	14	14	14	20	18	19	19
Derivativë financiarë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari të tjera të arkëtueshme	699	672	629	612	600	816	847	935	935
Totali	1,073	1,036	1,078	1,073	1,042	1,301	1,377	1,553	1,553
Detyrime									
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të borxhit	48	37	39	39	35	33	29	28	28
Hua	741	704	704	687	65	686	751	782	782
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	987	1,083	1,118	1,221	1,380	1,487	1,687	1,896	1,896
Sigurime dhe skemat e pensione	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Derivativë financiarë
Llogari të tjera të pagueshme	942	815	794	735	780	926	865	949	949
Totali	2,718	2,639	2,653	2,681	2,854	3,131	3,333	3,656	3,656

1 Zero absolute, zero e rumbullakosur ose vlera e papërfillshme

- Jo e aplikueshme


.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2022, struktura e detyrimeve të korporatave jofinanciare paraqitet si në vijim: "aksione dhe kapital tjetër" (51%), "llogari të tjera të pagueshme" (28%), "huatë" (20%) dhe "letra me vlerë të borxhit" (1%).

Detyrimet në “aksione dhe kapital tjetër” janë kryesisht me investitorët e huaj dhe ekonominë familjare, përkatësisht në masën 40% dhe 46.8%. Në vitin 2022, ky zë u rrit me 98 miliardë lekë në nivelin 1,994 miliardë lekë. Kjo rritje, në masën më të madhe, u diktua nga zgjerimi i pjesëmarrjes në kapital të sektorit të ekonomive familjare (me 121 miliardë lekë).

Detyrimet në “hua” të korporatave jofinanciare u rritën dhe në fund të vitit 2022, shënojnë 792 miliardë lekë. Ky zhvillim i atribuohet së bashku: zgjerimit të detyrimit ndaj sektorit të korporatave të tjera depozituese (detyrimit të kredisë në sektorin bankar) me rreth 18 miliardë lekë; rritjes së detyrimit në formën e huasë brenda sektorit (hua ndërkompani), me rreth 9.2 miliardë lekë; si dhe në masë më të vogël, rritjes së detyrimit ndaj sektorit të qeverisë së përgjithshme me rreth 3 miliardë lekë.



4.3 QEVERIA E PËRGJITHSHME


Të dhënat e sektorit të qeverisë së përgjithshme bazohen në informacionin e raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe nga të dhënat kundërpartii. Ky sektor paraqet të dhënat e konsoliduara për nënsektorin e qeverisë qendrore, nënsektorin e qeverisë lokale, dhe fondet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore¹².

Mjetet financiare në zotërim të qeverisë së përgjithshme vlerësohen në 484 miliardë lekë ose 6.4% të totalit të sektorëve të brendshëm të ekonomisë. Në terma vjetorë, ato u zvogëluan me 11%.

Zotërimet financiare të qeverisë janë kryesisht në formën e pjesëmarrjes në “aksione dhe kapital tjetër”. Në fund të vitit 2022, këto zotërime shënojnë 181 miliardë lekë, ku rreth 176.4 miliardë lekë janë aksione/pjesëmarrje në kapital në korporata publike jofinanciare dhe rreth 5.1 miliardë lekë është kapitali i bankës qendrore (llogaritë kapitale). Kapitali i bankës qendrore në

¹² Të dhënat e llogarive financiare të sektorit të qeverisë së përgjithshme përfshijnë kryesisht të dhënat e njësive buxhetore, kjo për të ruajtur harmonizimin me statistikat e tjera si llogaritë kombëtare, statistikat financiare të qeverisë (GFS) etj. Nga njësitë ekstrabuxhetore është përfshirë në të dhënat e qeverisë vetëm Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).

statistikat makroekonomike vlerësohet si pasuri publike dhe regjistrohet në sektorin e qeverisë së përgjithshme. Mjetet financiare në formën e “monedhave dhe depozitave”, gjatë vitit 2022, u ulën në nivelin e 92 miliardë lekë. Rënia u ndikua nga rënia e depozitave të transferueshme në bankën qendrore.



Tabelë 5. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të qeverisë së përgjithshme
Në miliardë lekë

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Mjete financiare									
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	23	37	34	48	78	57	54	133	92
Letra me vlerë të borxhit	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Hua	59	36	42	49	58	59	59	61	64
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	215	237	238	223	217	225	229	223	182
Sigurime dhe skema pensioni
Derivativë financiarë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	166	218	224	172	196	245	129	126	146
Totali	464	528	538	492	548	585	471	544	484
Detyrime									
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozita	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të borxhit	569	557	562	587	628	640	732	846	811
Hua	343	406	422	434	407	399	404	434	429
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Sigurime dhe skema pensioni	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Derivativë financiarë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të pagueshme	118	179	203	190	160	297	216	229	264
Totali	1,031	1,142	1,187	1,210	1,195	1,335	1,353	1,509	1,504


1 Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlera e papërfillshme

- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2022, detyrimet e qeverisë së përgjithshme vlerësohen në nivelin 1,504 miliardë lekë. Më shumë se gjysma e detyrimeve (54%) përbëhet nga "letrat me vlerë të borxhit". Stoku i "letrave me vlerë të qeverisë" përlogaritet në rreth 811 miliardë lekë¹³, nga 846 miliardë në fund të vitit 2021. Financuesi kryesor i borxhit të qeverisë së përgjithshme (hua dhe letra me vlerë) është sektori i korporatave financiare , i cili mban rreth 49% të totalit, pasuar nga sektori jorezidentëve në rreth 43%. Nënsektori i korporatave të tjera depozituese (bankat) ka financuar rreth 40% të totalit të borxhit të qeverisë. Detyrimet në llogari të tjera të pagueshme të qeverisë së përgjithshme për vitin 2022 u vlerësuan në rreth 264 miliardë lekë ¹⁴.



4.4 KORPORATAT FINANCIARE

Mjetet financiare të korporatave financiare në fund të vitit 2022 shënojnë 2,753 miliardë lekë dhe përfaqësojnë në masën 36% totalin e mjeteve të brendshme financiare të Shqipërisë.

Sektori i korporatave financiare¹⁵ përbëhet nga nënsektorët: banka qendrore (25%), korporata depozituese përveç bankës qendrore (68.4%), fondet e investimit (1.6%), shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit (1.5%) dhe institucionet e tjera financiare (3.5%).

Në masën më të madhe, zotërimet financiare të sektorit të korporatave financiare janë në formën e investimeve në "letra me vlerë të borxhit", me rreth 44% të totalit të mjeteve financiare në fund të vitit 2022. Zotërimet në "hua" dhe "monedha e depozita", gjithashtu zënë një pjesë të konsiderueshme të totalit të mjeteve financiare të këtij sektori, përkatësisht me 31% dhe 19%.

¹³ Në mungesë të informacionit mbi vlerën e tregut, vlera e stokut të letrave me vlerë të qeverisë së përgjithshme për letrat me vlerë të tregtuara në tregun e brendshëm është vlerësuar në vlerë nominale (çmimi i emetimit plus interesat e përlogaritura) si një përafrim më i saktë i vlerësimit për vlerën e tregut të këtij instrumenti.


¹⁴ Për më shumë mbi vlerësimet e të dhënave të qeverisë së përgjithshme në këtë instrument financiar shiko dokumentin metadata.

¹⁵ Lista e detajuar gjendet në lidhjen [Lista e institucioneve financiare në Shqipëri](#).


Në krahun e detyrimeve, instrumenti kryesor është “monedha e depozita”, në rreth 82% të totalit. Detyrimet në “kapital e aksione në fonde investimi” zënë 10% të totalit të detyrimeve të korporatave financiare.

Nënsektori i korporatave depozituese përveç bankës qendrore (sektori bankar) është dominues në performancën e të gjithë sektorit financiar. Ai zë mesatarisht 68% të totalit të mjeteve të sektorit dhe 25% të totalit të ekonomisë vendase. “Hua” dhe “letrat me vlerë të borxhit” janë instrumentet që dominojnë mjetet financiare të sektorit bankar, dhe në masë më të vogël “monedha dhe depozita”. Për nënsektorin e ndërmjetësve të tjerë financiarë, instrumentet financiare më të rëndësishme, si në mjete dhe në detyrime, janë “huaja” dhe “kapitali dhe aksione në fonde investimi”.


Grafik 22. Mjete financiare të korporatave financiare – instrumentet kryesore



Grafik 23. Detyrime të korporatave financiare – instrumentet kryesore



Grafik 24. Përbërja e mjeteve financiare të korporatave financiare, 2022



Grafik 25. Përbërja e detyrimeve të korporatave financiare, 2022



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të korporatave financiare
Në miliardë lekë

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Mjete financiare									
Ari monetar dhe SDR	19	31	27	26	20	24	41	54	47
Monedha dhe depozita	328	445	461	541	579	558	603	713	535
Letra me vlerë të borxhit	809	768	802	744	768	827	929	1,056	1,222
Hua	663	649	696	702	657	687	727	799	867
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	14	19	22	28	30	34	40	50	49
Sigurime dhe skemat e pensioneve	4	5	5	5	5	9	7	6	6
Derivatë financiare	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	16	16	23	26	22	27	26	27	27
Totali	1,853	1,933	2,036	2,073	2,081	2,166	2,375	2,706	2,753
Detyrime									
Ari monetar dhe SDR	8	8	8	7	7	7	7	27	26
Monedha dhe depozita	1,430	1,508	1,580	1,629	1,669	1,721	1,905	2,165	2,264
Letra me vlerë të borxhit	0	6	6	7	7	8	7	8	9
Hua	81	58	77	86	81	97	88	110	114
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	258	283	293	295	278	292	311	332	281
Sigurime dhe skemat e pensioneve	12	16	18	19	20	26	26	28	31
Derivatë financiare	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të pagueshme	18	21	18	16	20	22	27	35	35
Totali	1,807	1,901	2,000	2,060	2,081	2,173	2,371	2,705	2,759

1 Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlerë e papërfillshme

- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Mjete financiare dhe detyrimeve të nënsektorëve të korporatave financiare,
2021
Në miliardë lekë

	Banka Qendrore	Korporata të tjera depozituese	Fondet e Investimit	Ndërmjetësit e tjerë financiarë dhe Ndihmësit Financiarë	Kompanitë e Sigurimit dhe Fondet e Pensionit
Mjetet financiare					
Ari monetar dhe SDR	47	-	-	-	-
Monedha dhe depozitat	90	404	6	20	15
Letra me vlerë të borxhit	494	683	36	1	8
Huatë	53	763	2	48	0
Kapitali dhe aksionet në fondet e investimit	0	23	2	20	5
Sigurime, pensione dhe skema standarde garancish	6
Dervativët financiare	0	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	5	10	1	7	5
Totali	688	1,884	45	96	40
Detyrimet financiare					
Ari monetar dhe SDR	26	-	-	-	-
Monedha dhe depozitat	685	1,578	-	1	-
Letra me vlerë të borxhit	-	9	-	0	-
Huatë	0	75	0	38	1
Kapitali dhe aksionet në fondet e investimit	5	187	46	29	14
Sigurime, pensione dhe skema standarde garancish	-	-	-	-	31
Dervativët financiare	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	0	23	0	8	3
Totali	716	1,872	46	76	48

1 Zero absolute, zero e rrumbullakosur ose vlera e papërfillshme

- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: Banka Shqipërisë.


KORPORATA DEPOZITUESE PËRVEÇ BANKËS QENDRORE

Mjetet financiare të korporatave depozituese përveç bankës qendrore (sektori bankar) u zgjeruan me 93 miliardë lekë dhe në fund të vitit 2022 shënojnë 1,884 miliardë lekë.

Instrumenti financiar “hua” mban pjesën më të madhe të mjeteve financiare të këtij nënsektori, me përafërsisht 40% të totalit. Gjatë vitit 2022, këto zotërime u rritën me 57 miliardë lekë në nivelin 711 miliardë lekë. Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga zgjerimi i huasë akorduar sektorit të korporatave jofinanciare me 32 miliardë lekë dhe sektorit të ekonomive familjare me rreth 25 miliardë lekë. Kredia akorduar sektorit jorezident shënoi rënie në terma nominalë me 1.7 miliardë lekë, në ndryshim nga një vit më parë ku shënoi rritje me 5.4 miliardë lekë. Në fund të 2022, kjo kredi përfaqëson rreth 6% të portofolit të kredisë bankare nga 7% që shënonte në fund të vitit 2021.

Portofoli në “letra me vlerë të borxhit”, i cili përfaqëson rreth 36% të mjeteve financiare të sektorit bankar, u zgjerua me 36.6 miliardë lekë ose 6% në terma vjetorë. Në fund të vitit 2022, teprica në “letra me vlerë të borxhit” shënon 683 miliardë lekë. Investimet në letra me vlerë afatgjata të jorezidentëve mbeten atraktive dhe gjatë vitit u rritën me rreth 11%, duke zgjeruar peshën e tyre në totalin e letrave me vlerë në nivelin 28%.

Në krahun e detyrimeve, “monedha dhe depozita” përbëjnë komponentin kryesor të emetimit të detyrimeve financiare të sektorit bankar, në masën 84% të totalit, në fund të vitit 2022. Depozitat bankare gjatë këtij viti u zgjeruan me vetëm 87 miliardë lekë, në nivelin 1,578 miliardë lekë. Ky zhvillim është pasojë kryesisht e zgjerimit të bazës së depozitave të sektorit të brendshëm të ekonomisë.



FONDET E INVESTIMEVE


Gjatë vitit 2022, në tregun e fondeve të investimit ushtruan aktivitetin e tyre 13 fonde investimi, dy prej të cilave janë të regjistruara si fonde investimesh alternative.

Në fund të vitit 2022, mjetet financiare të fondeve të investimeve u zvogëluan me -32.8 miliardë lekë krahasuar me vitin 2021 dhe shënojnë vlerën e 45 miliardë lekëve.

Kjo rënie ka ardhur për shkak të rënies së vlerës së portofoleve të investimit të këtyre fondeve, të cilat dominohen kryesisht nga investime në letra me vlerë të borxhit të Qeverisë Shqiptare në masën 98%. Totali i investimeve në letra me vlerë gjatë vitit u zvogëlua në terma vjetorë me rreth 47% dhe në fund të 2022 shënon vlerën 35.6 miliardë lekë.

Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë vlerësohen në nivelin 30 miliardë lekë dhe përfaqësojnë në masën 67% totalin e mjeteve të brendshme të këtyre fondeve.

Grafik 28. Përberja e investimeve në letrat me vlerë të borxhit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga ana e detyrimeve, në konsiderata të llojit të ndërmjetësimit financiar që kryhet nga fondet e investimeve, detyrimi kryesor financiar i këtij nënsektori është në kuota (njësi) të fondit të investimit, të cilat përbëjnë 99.3% të detyrimeve financiare, në fund të vitit 2022. Në terma absolutë, stoku i këtij instrumenti ka shënuar një rënie prej 35.8 miliardë lekësh krahasuar me një vit më parë. Investitorë në fondet e investimeve janë kryesisht individët.

KOMPANITË E SIGURIMIT DHE FONDET E PENSIONIT

Tregu shqiptar i sigurimeve vijon me një ritëm relativisht të qëndrueshëm zgjerimi, dhe numri i shoqërive operuese në tregun e sigurimeve ka mbetur i njëjtë edhe gjatë këtij viti, në 12 kompani. Ndërkohë, në tregun e fondeve të pensioneve private ushtruan aktivitetin e tyre 6 fonde pensioni.

Për vitin 2022, mjetet financiare të kompanive të sigurimit dhe ato të fondeve të pensionit shënuan në total 40 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej rreth 3%. Së bashku, këta nënsektorë përfaqësojnë vetëm 1.5% në totalin e mjeteve të korporatave financiare.

“Monedha dhe depozita”, si dhe “letra me vlerë të borxhit” janë dy instrumentet më të rëndësishme financiare të mbajtura nga këta nënsektorë. Në fund të 2022, teprica në “monedha dhe depozita” shënoi 15.4 miliardë lekë dhe vlerësohet në rritje prej 14%.

Në krahun e detyrimeve, rezervat teknike dhe skemat e sigurimit të jetës dhe pensionit vjetor janë detyrimet kryesore financiare të nënsektorit të kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit. Në fund të vitit 2022, teprica e këtyre detyrimeve shënon 30.7 miliardë lekë dhe përbën 64% të totalit të detyrimeve financiare. Peshën kryesore të këtij detyrimi e përbëjnë rezervat e sigurimit të jojetës, me 73% të totalit.

Aksione ose njësi të fondeve të investimit ose llogaria e kapitaleve të veta, është një tjetër instrument i rëndësishëm financiar në totalin e detyrimeve financiare të këtij nënsektori (me rreth 28% të totalit).

